



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Drenasit**  
**Zyra e Kryetarit**



Nr 01-463/06-26826 dt. 05/06/2024

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur me nenin 24 dhe 25 të Rregullores Nr.(QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-Nr.436/06-5032, të datës 29.1.2024, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës se Glllogocit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. DL-546-2/24, të datës 21.02.2024, Vendimin të Kuvendit të Komunës Nr.02-Nr.436/06-5034, të datës 29.01.2024, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës se Glllogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr. VI-020-82/8, datë 21.02.2024, Kryetari i Komunës lidh kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese:

**KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË  
PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

**Neni 1**

**Palët**

- 1) Komuna e Glllogocit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe
- 2) Ministria e Ekonomisë, me numër fiskal 600376653, të cilën e përfaqëson znj. Artane Rizvanolli, në tekstin në vijim "Shfrytëzuesi i Pronës".

**Neni 2**

**Lënda e Kontratës:**

Duke iu nënshtruar kushteve të parashtuara në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues i jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet operatorit ekonomik, dhe operatori ekonomik merr në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet nga Autoriteti Kontraktues, parcelën kadastrale P-70314033-00872-4 me sip.100 m<sup>2</sup> zona kadastrale Kishnarekë, Komuna e Glllogocit.

**Neni 3**

Autoriteti Kontraktues është pronar i pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, në tekstin në vijim e referuar si "objekti i kontratës".

#### Neni 4

4.1 Objekti i kontratës është i para destinuar nga Autoriteti Kontraktues për përmbushjen e interesit të përgjithshëm.

Shfrytëzuesi i pronës do të shfrytëzoj objektin e kontratës për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve “Ndërtimi i Stacionit Sizmik Sekondar”, sipas kërkesës/planit nr.01-420 të datës 22.1.2024 të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

4.2 Shfrytëzuesi i pronës obligohet që t’i përmbahet planit dinamik sipas kërkesës/planit nr.01-420 të datës 22.01.2024, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-Nr.436/02-5034, të datës 29.01.2024, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës se Glllogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr. 020-834/18, të cilat janë pjesë e kësaj kontrate.

4.3 Shfrytëzuesi i Pronës obligohet të fillojë punën në afat prej 6 muajsh, nga dita e marrjes së lejes së fundit.

#### Neni 5

Shfrytëzuesi i pronës e merr pa pagesë, në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të komunës, duke marr parasysh interesin e përgjithshëm.

#### Neni 6

Autoriteti Kontraktues pajtohet t’i ofroj qasje të lirë shfrytëzuesit të pronës në objektin e kësaj kontrate, për tërë periudhën e shfrytëzimit të tij.

#### Neni 7

Objekti i kontratës

7.1. Autoriteti Kontraktues ia jep në shfrytëzim pronën Shfrytëzuesit të Pronës, ndërsa Shfrytëzuesi i Pronës e merr në shfrytëzim nga Autoriteti Kontraktues objektin e përshkruar si vijon:

7.2. Fletat poseduese

7.3. Kopjet e Planit

7.4. Madhësia e tokës

7.5. Të dhënat tjera në lidhje me tokën.

#### Neni 8

Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm:

8.1. Duke iu nënshtruar edhe afateve të tjera të kësaj Kontrate, kohëzgjatja e kësaj Kontrate për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është për 99 vite me mundësi vazhdimi, që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

8.2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës e ka të drejtën e marrjes vendimit për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

8.3. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit.

8.4 Nëse Shfrytëzuesi i Pronës nuk e plotëson ndonjë kusht paraprak, Autoriteti Kontraktues mund të anulojë këtë Kontratë, duke e njoftuar me shkrim Shfrytëzuesin e Pronës për këtë dhe të kërkoj dëmshpërblimin sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8.5. Shfrytëzuesi i Pronës ka të drejtë që, në diskrecionin e tij të vetëm dhe të plotë, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, ta anulojë këtë Kontratë para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për dëmshpërblim, duke e njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues për synimin e tij për ta anuluar këtë Kontratë. Shfrytëzuesi i pronës duhet ta njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës me të cilën synon ta anulojë këtë Kontratë.

#### Neni 9

9.1 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

9.2 Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

9.3. Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

#### Neni 10

Mbikëqyrja e kontratave:

10.1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.

10.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Neni 11

Shfrytëzuesi i Pronës obligohet t'i përmbahet Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-Nr.436/06-5034, të datës 29.01.2024, në raste të mos përmbushjes së tyre Kryetari i Komunës ka të drejtë ta shkëpus kontratën në mënyre të njëanshme.

Neni 12

Shfrytëzuesi i Pronës obligohet që pas nënshkrimit të kësaj kontrate, t'i përmbahet afatit të paraparë në planin dinamik, të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore për fillimin e punimeve, duke siguruar shfrytëzimin apo destinimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm.

Neni 13

Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do t'i zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje, dhe në rast se këtë nuk mund të arrijnë atëherë kontestet do të zgjidhen në Gjykatën Kompetente.

Neni 14

Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplar të mjaftuar për palën kontraktuese. Palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

Neni 15

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrim nga ana e palëve kontraktuese.

Ministria e Ekonomisë

Artane Rizvanolli



Kryetari i Komunës

Ediz Lladrovci

